

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10018 DATË 13.11.2008 “PËR AVOKATURËN E SHTETIT”

I. GJETJET DHE PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA NË ANALIZËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË DHE NEVOJA E NDRYSHIMIT TË LIGJIT

Në dokumentin e analizës së sistemit të drejtësisë është evidentuar se praktika ka identifikuar pengesë në aspektin e zbatimit efektiv të parimit të ekskluzivitetit për avokaturën e shtetit. Për këtë arsye asistenca e Avokaturës së Shtetit shpesh kërkohet me vonesë nga autoritetet shtetërore. Lëvizjet e vazhdueshme dhe dështimi për të krijuar një traditë të vërtetë të cilësisë institucionale dhe profesionale ka çuar në cilësi të ulët të shërbimeve të Avokaturës së Shtetit. Mungesa e garancive ligjore për avokatët e shtetit ka ndikuar gjithashtu negativisht për qëndrueshmërinë, cilësinë dhe vazhdueshmërinë. Në dokumentin e strategjisë është parashikuar si objektiv fuqizimi i rolit të Avokaturës së Shtetit për përfaqësimin e interesave pasurorë të shtetit. Ka lindur nevoja për të ndërhyrë në ligj, me qëllim përmirësimin dhe qartësimin e ligjit dhe krijimin e mundësive dhe pavarësisë së institucionit dhe në planin e veprimit është parashikuar të bëhen amendime të ligjit ekzistues për avokaturën e shtetit

Me anë të propozimeve të këtij projektligji synohen të rregullohen një sërë problematikash dhe vakumesh ligjore të hasura gjatë një përvojë pune 15 vjeçare në Institucionin e Avokaturës së Shtetit. Avokatura e Shtetit është institucion i krijuar në Republikën e Shqipërisë për herë të parë në vitin 1999. Në vitin 2006, Avokatura e Shtetit pësoi disa ndryshime, duke kaluar nga varësia e Kryeministrit (si edhe kishte qenë prej krijimit të tij) në varësi të Ministrit të Drejtësisë. Në vitin 2008, institucioni i Avokaturës së Shtetit ndryshoi rrënjësisht me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Avokaturën e Shtetit, i cili u hartua mbi modelin e *Abogacia General del Estado* (Avokatura e Përgjithshme e Shtetit e Mbretërisë së Spanjës) nga Ministria e Drejtësisë me kontributin e ekspertëve spanjollë.

Në përmbushje të kuadrit ligjor në fuqi, Avokatura e Shtetit është institucioni që ka ekskluzivitetin e asistencës juridike të institucioneve shtetërore dhe enteve publike. Asistenca juridike përfshin këshillimin dhe përfaqësimin gjyqësor¹. Të dy këto elementë janë praktikisht gjithnjë të detyrueshëm, në kuptimin që organi i interesuar i administratës publike **duhet** të kërkojë këshillimin apo përfaqësimin nga Avokatura e Shtetit, sa herë që veprimtaria juridike apo çështja gjyqësore paraqet një komponent “financiar” apo “pasurorë”².

Përmes këshillimit paraprak mbi veprimet juridike që parashikojnë efekte financiare, përmes mendimeve juridike mbi projekt-kontratave dhe përmes pjesëmarrjes në negociimin e kontratave të rëndësishme, Avokatura e Shtetit luan një rol kyç në **garantimin e interesit publik pasuror**.

¹Neni 2, par. 2 i ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 « Për Avokaturën e Shtetit »

²Nenet 2 dhe 5 të Ligjit për Avokaturën e Shtetit

II. PROCESI I HARTIMIT TË PROJEKTLIGJIT DHE METODOLOGJIA E PUNËS

Për përgatitjen e këtij projektligji u ngrit grupi i punës i përbërë nga ekspertë të nivelit të lartë dhe ekspertë të sekretariatit teknik si dhe grupi i konsultimeve Think Tank me përfaqësues nga opozita, Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Lartë dhe përfaqësues të Avokaturës së Shtetit. Në fillim të procesit të draftimit të këtij projektligji është përgatitur një vlerësim paraprak ku është parashikuar një përmbledhje e ndërhyrjeve të propozura, arsyetimin e nevojshmërisë së këtyre ndërhyrjeve dhe standartet ndërkombëtare ku do të mbështeten. Grupi i punës dhe grupi i konsultimeve Think Tank kanë zhvilluar disa takime ku janë diskutuar ndryshimet e propozuara në projektligjin për avokaturën e shtetit.

Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj për shkak të natyrës së tyre, janë paraprirë nga ndryshime edhe në kuadrin ligjor që rregullojnë institucione të tjera, si psh Ligji Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, duke qënë se në projektligj janë propozuar elemente që kanë lidhje direkte me këtë ligj.

Për hartimin e projektligjit është mendimi i avokatëve të shtetit, ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë si dhe u bashkëpunua ngushtë me Euralius, ekspertë ndërkombëtarë, profesorë të së drejtës dhe aktorë të tjerë në fushën e drejtësisë.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i hartuar nga grupi i ekspertëve, i paraqitet për shqyrtim e miratim Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, sipas rregullave të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit.

III. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj synon fuqizimin e rolit të Avokaturës së Shtetit për përfaqësimin e interesave pasurorë të shtetit, duke parashikuar dispozita lidhur me forcimin e asistencës së Avokaturës së Shtetit për organet shtetërore, rritjen e kapaciteteve të avokatëve të shtetit me anë të trajnimeve, parashikimin e garancive ligjore për avokatët e shtetit lidhur me qëndrueshmërinë, cilësinë dhe vazhdueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Ndryshimet do të dallohen në elementë të veprimtarisë së avokaturës sa i përket ekskluzivitetit, kategorisë së çështjeve që perfaqëson, subjekteve, veprimtarisë këshillimore për veprimtarinë juridike, veçanërisht për lidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë efekte financiare për shtetin.

Nga praktika e deritanishme dhe nevojat e zhvillimeve sociale ka lindur domosdoshmëri, që të ndërhyet në ligj, edhe në lidhje me statusin e avokaturës dhe të avokatëve të shtetit, duke u parashikuar formimi profesional, karriera dhe statusi i avokatëve të shtetit.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara, synohet të disiplinohet ndërhyrja dhe pjesëmarrja e avokatit të shtetit në procesin gjyqësor ku diskutohen interesat pasurorë të shtetit.

a. Praktika, ka evidentuar mangësi përse i përket "varësisë" së Avokaturës së Shtetit nga Ministri i Drejtësisë. Në projektligjin e ri, Avokatura e Shtetit është parashikuar të kalojë në varësi të Kryeministrit. Në këtë mënyrë, do të rritet niveli i përfaqësimit, pavarësia dhe autoriteti i Avokaturës së Shtetit si dhe do të ndikojë në rritjen e nivelit të përfaqësimit. Do të shmanget "konflikti" i nomenklaturës dhe përfaqësimit pasi, duke qenë në varësi të Ministrit të Drejtësisë mungon autoriteti për të këshilluar ministri të tjera dhe njëkohësisht për të realizuar delegimet. Duke qenë në varësi të Ministrit të Drejtësisë, ministrinë e tjera, në fakt dhe *ipso jure* konsiderohen në varësi të Ministrit të Drejtësisë. Kalimi në varësi të Kryeministrit, do të rrisë kontrollin mbi këtë institucion dhe komunikimi me Kryeministrin dhe Këshillin e Ministrave do të jetë i drejtpërdrejtë, duke shkurtuar disa hallka dhe duke gjetur zgjidhje për problematikat, në mënyrë të shpejtë dhe efektive. Praktika e deritanishme, ka treguar se ndryshimi dhe kalimi në varësi të Ministrisë së Drejtësisë ka qenë me efekte në drejtim të autoritetit dhe pavarësisë së Avokaturës së Shtetit.

Në mënyrë më të detajuar, ky ndryshim motivohet si vijon:

1. Objekti i veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit mbulon "mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit"³, pavarësisht se nga cila veprimtari rrezikohet pakësimi apo dëmtimi i saj. Kjo do të thotë, që veprimtaria e Avokaturës së Shtetit ka fushë veprimi të përgjithshme, duke u shtrirë aktiviteti i saj mbi të gjitha Ministrinë, organet e hetimit dhe të gjitha nivelet e gjyqësorit. Fushëveprimi i kufizuar i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrive të tjera të vecanta, Ekonomia, Financa, Mbrojtja etj. nuk e justifikojnë qenien e Avokaturës së Shtetit në varësinë e ndonjëres prej tyre.
I vetmi autoritet që mund të justifikojë strukturën organizimin dhe kontrollin mbi Avokaturën e Shtetit është Kryeministri, i cili në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, paragrafi 1, shkronja b, koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to. Realizimi i objektit të veprimtarisë së Kryeministrit rezulton në harmoni me objektin dhe shtrirjen e veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit.
2. Duke u rikthyer në varësi të Kryeministrit, do të rritet, duke justifikuar seriozitetin e përfaqësimit, pavarësia dhe autoriteti i Avokaturës së Shtetit si dhe do të ndikojë në rritjen e nivelit të përfaqësimit. Në varësi të Kryeministrit shmanget "konflikti" i nomenklaturës dhe përfaqësimit. Qënia në varësi të Ministrit të Drejtësisë krijon mospërputhje midis autoritetit për të këshilluar Ministri të tjera si dhe për të realizuar, në raste të veçanta delegime. Duke qenë institucioni i Avokaturës së Shtetit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe strukturë e varur prej tij, nëpërmjet ushtrimit të aktivitetit të tij, realizohet "*de facto*" superioriteti i Ministrisë së Drejtësisë në raport me Ministrinë e tjera.
3. Qënia në varësi të Kryeministrit, mundëson kontroll dhe komunikim të drejtpërdrejtë të Kryeministrit për realizimin e politikave të shtetit. Shkurtimi i hallkave të panevojshme dhe që vonojnë proceset e Avokaturës së Shtetit do të zgjidhë problematika të cilat janë vërejtur në veprimtarinë dhe rezultatet në lidhje me mbrojtjen e interesave pasurorë të

³ Neni 5 i Ligjit "Per Avokaturen e Shtetit"

shtetit. Veprime të caktuara, të cilat janë në funksion të zbatimit të detyrave që burojnë nga politikat e shtetit mund dhe duhet të miratohen drejtpërdrejtë nga Këshilli i Ministrave, i cili është subjekti kushtetues përgjegjës. (Shëmbull: Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Evropiane pregatitet nga Avokatura e Shtetit ndërkohë që, projektvendimi i Këshillit të Ministrave kalon nëpër hallka të panevojshme të Ministrisë së Drejtësisë, të cilat objektivisht vonojnë procesin e ekzekutimit, e njëjta situatë dallohet në prokurimet e autoriteteve juridike në ndihmë të veprimtarisë në arbitrazh apo përpara gjykatave të huaja). Kjo veprimtari jashtë kompetencës dhe fushës vendimmarrëse për shkak të rëndësisë së saj duhet të miratohet nga Kryeministri. Janë të shumta dhe raste të tjera të cilat dalin nga fushëveprimi i Ministrisë së Drejtësisë.

4. Në bazën ligjore ekzistuese në lidhje me Avokaturën e Shtetit dhe Ministrinë e Drejtësisë përveç kohezionit të legjislacionit dallohen edhe mungesa reciproke. Në Ligjin Nr.8678, datë 14.05.2001, i ndryshuar “Për Organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, nuk figuron Institucioni i Avokaturës së Shtetit, jo vetëm në aspektin strukturor por edhe në detyrat dhe objektivat e veprimtarisë së saj.

b. Përsa i përket “*parimit të ekskluzivitetit*”, janë vërejtur mangësi në legjislacion, përmendim “varësinë e dyfishtë të avokatëve të shtetit”, e cila reflektohen mangësi edhe në praktikë. “Parimi i ekskluzivitetit” lidhet posaçërisht me kompetencat e Avokatit të Shtetit për këshillimin dhe përfaqësimin e organeve të administratës dhe enteve publike. Pikërisht qartësimi dhe sanksionimi i saktë i këtij parimi në projektligjin e propozuar si dhe saktësimi i fushave ku ky parim do të aplikohet synohet të arrihet me ndryshimet e propozuara.

c. Duke marrë në konsideratë, natyrën e posaçme të funksioneve dhe veprimtarisë të Institucionit të Avokatit të Shtetit, si dhe interesin e lartë publik, atë të mbrojtjes së interesave financiare dhe pasurore të shtetit Shqiptar, me anë të ndryshimeve të propozuara synohet të sanksionohet qartë në projektligj “*Statusi i Avokatëve të Shtetit*”. Pikërisht, praktika ka treguar, që mungesa e një garancie të tillë ligjore për Avokatët e Shtetit, ka ndikuar në qëndrueshmërinë, cilësinë dhe vazhdueshmërinë normale të ushtrimit të funksioneve të tyre. Rrjedhimisht, duke qenë se Institucioni i Avokaturës së Shtetit për nga vetë natyra dhe funksioni i tij është pjesë e korpusit të sistemit të drejtësisë, miratimi i dispozitave lidhur me *garancinë mbrojtëse funksionale/ Statusin e Avokatit të Shtetit*, për figurat që do të jenë pjesë e kësaj strukture, nuk do të bëjë gjë tjetër veçse do të përmirësojë funksionimin cilësor të hallkave të këtij sistemi.

Përcaktimi i statusit të avokatëve të shtetit duke i barazuar me atë të prokurorit është bazuar edhe në praktikat e disa prej vendeve, të cilat e kanë këtë institucionon, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Vendi	Statusi i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit (APSH) dhe Avokatëve të Shtetit (ASH) në raport me magjistratët
1	Qipro	Statusi i APSH = statusin e Anëtarit të Gjykatës së Lartë
2.	Malta	Statusi i APSH = status gjyqtari
3.	Slovenia	Statusi i ASH = status gjyqtari + dita vite eksperiencë më shumë

4.	Itali	Statusi i APSH = statusi i Prokurorit të Përgjithshëm në Gjykatën e Lartë
5.	Spanjë	Statusi i ASH = status gjyqtari
6.	Poloni	Statusi i ASH më i lartë se ai i gjyqtarit ose prokurorit (kështu personat që duan të bëhen avokatë shteti dhe kanë kaluar provimin e gjyqtarëve ose prokurorëve, mund të bëhen avokatë shteti, pa qenë nevoja për t'iu nënshtruar provimit përkatës, vetëm nëse kanë jo më pak se 3 vite punë.
7.	Mbretëria e Bashkuar	Statusi i APSH = Ministër qeverie

d. Në praktikë, Avokatura e Shtetit haset çdo ditë me një numër të madh çështjesh të natyrës civile dhe administrative ku palë është një nga institucionet e administratës publike. Në këtë linjë, dhe duke marrë për referencë volumin e çështjeve sipas institucioneve, në propozimet e paraqitura është parashikuar krijimi pranë çdo *Ministrie* i zyrave me një ose disa Avokatë Shteti për ushtrimin e funksioneve këshillimore dhe të përfaqësimit. Krijimi i këtyre zyrave do të jetë në funksion të zbatimit real të parimit të ekskluzivitetit që synohet të sanksionohet me propozimet e këtij projektligji, specializimit të Avokatëve të Shtetit në fushat përkatëse, dhe në mënyrë të veçantë efikasitetin financiar duke rregulluar situatat e mbivendosjes së kompetencave midis Avokatëve të Shtetit dhe Juristëve të institucioneve gjatë ushtrimit të funksioneve këshillimore dhe të përfaqësimit.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për mendim duke marrë në konsideratë veçantinë funksionale të Institucionit të Avokaturës së Shtetit dhe eksperiencën 15 vjeçare të ushtrimit të veprimtarisë së tij, në radhë të parë synon mirërregullimin dhe mirëfunksionimin e Institucionit të Avokaturës së Shtetit, si një nga institucionet e rëndësishme të mbrojtjes së interesave financiare dhe pasurore të shtetit Shqiptar, përpara gjykatave të brendshme të të gjitha niveleve, gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe të arbitrazhit ndërkombëtar.

*Në nenin 1 të projektligjit është parashikuar ndryshimi i nenit 2, të ligjit "Për Avokaturën e Shtetit" në kuadër të rregullimit të çështjeve që ndihmojnë në rritjen e profesionalizmit dhe cilësisë të asistencës juridike që ofron Avokatura e Shtetit⁴.

Në Pikën 1 është parashikuar kalimi i Avokaturës së Shtetit, në varësi të Kryeministrit. Kjo është bërë me qëllim për të rritur nivelin e përfaqësimit të avokaturës, për të dhënë autoritet dhe pavarësi më të madhe si dhe, për të shmangur konfliktet, të cilat mund të rrjedhin nga qenia në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe përfaqësimi dhe i Ministrive të tjera. Gjithashtu, kalimi në varësi të Kryeministrit, do të shmangë, shpeshherë zvarritje në raportimin e problemeve të konstatuara dhe gjetjen e zgjidhjeve efektive si dhe do të rritet përgjegjësia dhe niveli i kontrollit ndaj institucionit. Në plotësim të Pikës 1 të këtij neni është propozuar dhe ndryshimi i pikës 4, në të cilën parashikohet se, Avokatura e Shtetit do të financohet nga Buxheti i Shtetit dhe jo më nga Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, duke i garantuar institucionit më shumë pavarësi.

Në pikën 2 të projektligjit është propozuar ndryshimi i fjalisë së fundit, duke theksuar detyrimin për përfaqësimin ekskluziv nga Avokatët e Shtetit të organeve të administratës

⁴ Neni 1 i Projektligjit "Mbi disa ndryshime në Ligjin 10018/2008

publike për këshillimin juridik dhe përfaqësimin sipas çështjeve juridike që përcakton ligji në nenin 5 të tij. Vlen të theksojmë se termi “*ekskluzivisht*” është menduar të theksohet duke marrë shkas nga problematikat e vërejtura në praktikën e punës disavjecare në Avokaturën e Shtetit. Në jo pak raste konfliktesh gjyqësore, të institucioneve të administratës publike, Avokatët e Shtetit ose nuk vihen në dijeni ose thirren për të përfaqësuar institucionin, në hapa të ndryshëm të procesit gjyqësor, kur efektivisht ka qenë e pamundur realizimi i mbrojtjes për të patur një vendim në favor të shtetit. Për më tepër, në jo pak raste të tjera janë konstatuar mbivendosje kompetencash, ku si palë mbrojtëse në seancat gjyqësore paraqiten njëkohësisht si Avokati i Shteti edhe Juristi i institucioneve, gjë që sjell jo vetëm mbivendosje kompetencash, por në nivel më praktik mungesë eficence në organizimin e burime njerëzore dhe resurseve financiare. Në këtë kuptim, me anë të ndryshimeve të propozuara në projektligj synohet që të sanksionohet “parimi i ekskluzivitetit” në mënyrë që Avokatët e Shtetit të jenë të vetmit përfaqësues të administratës publike në sistemin gjyqësor për mbrojtjen e interesit financiar dhe pasuror të shtetit Shqiptar.

Me këtë synim është bërë dhe një shtesë e Pikës 2 të nenit 2, në të cilën sanksionohet se:

“Avokatët e shtetit pranë zyrave vendore, përfaqësojnë dhe mbrojnë, pa autorizim, pranë gjykatave ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre.” Pra, avokatëve të shtetit, autorizimin për përfaqësim, tashmë ja njeh ligji, “përfaqësimi ligjor”, duke shmangur në këtë mënyrë, vonesat dhe procedurat e burokratike për marrjen e një autorizimi të veçantë, për përfaqësimin e interesave të shtetit.

Në pikën 4, është parashikuar financimi i Avokaturës së Shtetit nga Buxheti i Shtetit, dhe jo më nga Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, duke qenë se është propozuar ndryshimi i varësisë së Institucionit të Avokaturës.

* Në nenin 2 të projektligjit është parashikuar të shtohet, pika 2 e nenit 3 të ligjit, me këtë përmbajtje: *“Asistenca e dhënë dhe marrëdhëniet midis Avokaturës së Shtetit dhe organit të interesuar, janë konfidenciale”*. Kjo bëhet në kuadër të mbrojtjes më të mirë të interesave të përgjithshme të shtetit. Parimi i konfidencialitetit, garanton mbarëvajtjen dhe ndjekjen më të mirë të çështjes gjyqësore dhe është një ndër parimet bazë, në institucionin e mbrojtjes.

* Në nenin 3 të projektligjit, propozohet ndryshimi i nenit 4, pika 3 gërma (b) “krijimi i zyrave të Avokaturës së Shtetit pranë ministrive”. Një përcaktim i tillë lind si domosdoshmëri, duke marrë volumin e madh të çështjeve gjyqësore, që kanë disa Ministri. Volum, i cili është i pamundur të mbulohet vetëm nga një avokat. Kjo, sigurisht, do të ndikojë në përfaqësimin më të mirë të interesave shtetërorë. Ky propozim nuk ka në qëllimin e tij fryrjen e organikës, por mirë regullimin dhe mirë organizimin e punës, ndarjen e qartë të punës dhe specialiteteve midis avokatëve të ngarkuar në detyrë. Sigurisht që nëse do të jetë i nevojshëm shtimi i organikës, kjo kalon në një procedurë tjetër, si edhe në nenet e mëposhtme.

Gjithashtu, në varësi të ndryshimeve që janë bërë në kuadër ndryshimit të varësisë, në pikat 2 dhe 3 të këtij neni propozohet ndryshimi i pikave 5 dhe 6 të nenit 4 të ligjit, duke përcaktuar se *“struktura dhe organika e Avokaturës së Shtetit do të miratohen me urdhër të Kryeministrit, dhe me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave”*, ndërsa, *“rregullorja e brendshme e funksionimit të Avokaturës së Shtetit” do të miratohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit*.

*Në nenin 4 të projektligjit, propozohen disa shtesa dhe ndryshime në nenin 5 të ligjit. Është propozuar saktësimi i personave juridikë, të cilët do të përfitojnë asistencë juridike nga Avokatura e Shtetit, duke u shtuar Pika 1/1, në këtë nen. Gjithashtu, janë sanksionuar rastet kur avokatura e shtetit nuk ofron asistencë juridike.

Në pikën 2, pas shkronjës (c) shtohet pika (ç), me këtë përmbajtje: “ç) për hartimin e akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të të drejtës publike dhe çështjeve gjyqësore që lidhen me këto procese, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.”

Në këtë nen, është shtuar, ndër të tjera, Pika 3, e cila sanksionon edhe njëherë “parimin e ekskluzivitetit” si dhe përcakton se, “personat juridikë” mund të përfaqësohen vetë vetëm në rastet kur është e përcaktuar në ligj.

*Në nenin 5 të projektligjit, janë parashikuar ndryshime dhe shtesa në nenin 6 të Ligjit ekzistues, në reflektim të ndryshimeve të varësisë së institucionit, të bëra në nenin 2. Tashmë është parashikuar se procesi i llogaridhënies, raportimeve dhe ofrimi i propozimeve konkrete për ndërmarrjen e nismave ligjore, për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi, në varësi të problematikave të konstatuara gjatë veprimtarisë saj, do të bëhet pranë “Kryeministrit”. Gjithashtu, në këtë nen, në pikën 3 të tij është parashikuar ndryshimi i gërmës “h”, duke u përcaktuar roli i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit si “agjent qeveritar”, në përfaqësimin pranë Gjykatës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut.

* Në nenin 6 të projektligjit janë propozuar shtesa dhe ndryshime në nenin 9 të ligjit ekzistues. Konkretisht, në pikat 1,2 të nenit 6 përcaktohet se Avokatët e Shtetit në ushtimin e funksioneve të tyre ndihmohen nga Juristë. Sanksionimi i një parashikimi të tillë është bërë së pari, duke marrë për bazë ngarkesën e madhe që ka kjo zyrë në çështjet që paraqiten dhe rolin ndihmës që luajnë Juristët në përgatitjen e dosjeve për Avokatët e Shtetit. Ndërkohë mënyra e përzgjedhjes së tyre është tashmë një çështje e zgjidhur në ligjin ekzistues (shiko nenin 9 pika 5). Po në këtë nen, për shkak të rëndësisë së veçantë, por edhe të shtimit në mënyrë të konsiderueshme të çështjeve gjyqësore, në të cilat shteti shqiptar është i paditur, pranë Gjykatës Evropiane të Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, është parashikuar emërimi në rolin e agentëve qeveritar edhe i avokatëve të tjerë të shtetit, të cilët do të kenë rolin e bashkëagjentit me Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit. Në këtë frymë është parashikuar dhe rritja e numrit të përfaqësuesve ligjorë të përhershëm pranë Gjykatës Evropiane të Lirive dhe të Drejtave të Njeriut.

Pas Pikës 5, shtohet Pika 5/1, me këtë përmbajtje: *“Në rast arbitrazhi ndërkombëtar në fushën e investimeve, ku palë është Republika e Shqipërisë, organi i interesuar, sipas këtij ligji, konsiderohet Ministria përgjegjëse, e cila mbulon shpenzimet e nevojshme për përfaqësimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë. Kur kjo nuk mund të identifikohet, organi i interesuar konsiderohet ministria përgjegjëse për investimet e huaja.”* Ky ndryshim ka ardhur si rrjedhojë e praktikës së hasur për çështjet që Avokatura e Shtetit ndjek në arbitrazhin Ndërkombëtar.

*Në nenin 7 të projektligjit është parashikuar ndryshimi i nenit 11, Pika 6, i cili ka ardhur si rrjedhojë e vendosjes së Avokaturës së Shtetit, në varësi të Kryeministrit. Tashmë, do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, ai që do të sigurojë dhe garantojë mirë funksionimin e zyrave vendore në mjedise shtetërore. Me këtë ndryshim, përveç arsyeve të përmendura më lart, synohet ti jepet fund gjendjes në të cilën janë zyrat vendore në avokaturën e shtetit, përsa i përket funksionimit të tyre.

* Në nenin 8 të projektligjit është propozuar ndryshimi i nenit 12 të ligjit ekzistues. Është propozuar ndryshimi për krijimin pranë çdo *Ministrie të zyrave me një ose disa Avokatë Shteti për ushtrimin e funksioneve këshillimore dhe të përfaqësimit*. Në lidhje me këtë pikë, saktësojmë se, nevoja për krijimin e zyrave pranë çdo Ministrie me 1 ose disa Avokatë Shteti ka lindur për shkak të numrit të madh të çështjeve gjyqësore ku Ministrinë janë pjesë e procesit gjyqësor. Për më tepër, parashikimi i kësaj dispozite është në funksion e rregullimit

të situatave të mbivendosjes së kompetencave dhe parimit të ekskluzivitetit që synohet të sanksionohet me propozimet e këtij projektligji.

Marrë shkas nga praktika e deritanishme, parashikohet që pranë *Ministritë së Financave*⁵, *Ministritë së Energjitikës dhe Industrisë*⁶, *Ministritë të Zhvillimit Urban dhe Turizmit*⁷ të ketë të atashuar më shumë se një Avokat Shteti, për shkak të ngarkesës së madhe të çështjeve që kanë këto Ministri për trajtim. Gjithashtu, në këtë nen, qartësohet dhe varësia e avokatëve të shtetit, pranë ministrive, duke u vendosur tashmë që do të kenë varësi vetëm nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

*Në nenin 9 të projektligjit është parashikuar ndryshimi i vlerës së dëmit, në “2 milion” lekë, në rastet e delegimit të së drejtës për të ngritur padi, organit qëndror ose vendor.

*Në nenin 10 të projektligjit parashikohet ndryshimi i nenit 15 të ligjit ekzistues, duke propozuar për ndryshim *fushën e këshillimit paraprak* të organit të administratës publike me Avokaturën e Shtetit, duke përcaktuar qartësisht edhe *rastet e detyrueshme për këshillim*. Përcaktimi i qartë i *rasteve të detyrueshme për këshillim paraprak* është propozuar duke marrë për bazë rastet praktike të trajtuara nga Avokatura e Shtetit, ku këshillimi paraprak i institucioneve të administratës publike ka rezultuar efektiv në shumë raste, për më tepër në reduktimin apo eliminimin e dëmeve financiare si pasojë e marrdhënieve kontraktuale. Nga ana tjetër, ngushtimi i fushave të kontratave për këshillim dhe qartësimi i *rasteve të detyrueshme për këshillim paraprak*, do të unifikoje praktikën administrative në këtë drejtim, duke mos e lënë thjesht në vlerësimin e institucionit se, në cilat raste duhet ti drejtohet për këshillim paraprak Avokaturës dhe në cilat raste jo.

Ndërkohë përfshirja në këshillimin paraprak të detyrueshëm lidhur me *kontrata publike për kryerje punimesh, furnizim mallrash apo furnizim shërbimesh* është përfshirë në ndryshimet e këtij projektligji, duke patur në vëmendje rastet kur kontratat e shërbimeve dhe furnizimeve kanë një vlerë të madhe financiare dhe sigurisht një impakt të konsiderueshëm për institucionet. Për rastet e tjera, kontratat e thjeshta, të cilat nuk kanë efekt të rëndësishëm financiar, sipas ligjit nuk janë objekt shqyrtimi nga Avokatura e Shtetit. Gjithashtu, nga problemet e konstatuara në kontratat e lidhura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazhin ndërkombëtar, ndër të tjera është parashikuar dhënia e këshillimit për këto lloj kontratash.

Pas pikës 9, shtohet pika 10 me këtë përmbajtje: “*Këshillimi mund të delegohet tek organi i interesuar, me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Kushtet dhe kriteret për delegimin e këshillimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave*”. Ky ndryshim është propozuar për të plotësuar kuadrin ligjor ekzistues. Një delegim i tillë bëhet tashmë nga Avokatura për përfaqësimin në çështjet gjyqësore dhe parashikohet për t’u bërë edhe me këshillimet, me qëllim që Avokatura si institucion i specializuar për asistencën juridike, të merret me trajtimin e çështjeve që paraqesin rëndësi të veçantë për mbrojtjen e interesave pasurore të shtetit dhe që nuk mund të mbulohen nga vetë institucionet.

*Në nenin 11 të projektligjit është parashikuar ndryshimi i nenit 16, tashmë raportimi bëhet vetëm tek Kryeministri, në ato raste kur institucionet e tjera nuk sigurojnë informacionin apo dokumentacionin e kërkuar nga Avokatura e Shtetit, në kohën e duhur.

⁵ Për shkak të pasjes në varësi Institucionin e Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

⁶ Për shkak të pasjes në varësi Shoqëritë KESH dhe OST.

⁷ Për shkak të pasjes në varësi të strukturës së INUK

*Një ndryshim i rëndësishëm është dhe ai i propozuar në nenin 12 të projektligjit. Sipas këtij ndryshimi, zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike, do të materializohet në një akt, në prani të Avokaturës së Shtetit. Më pas kjo marrëveshje do të përcillet nga Avokatura e Shtetit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë përkatëse, për miratim. Në këtë mënyrë, garantohet zgjidhja e shpejtë dhe efektive e mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike.

*Në nenin 13 të projektligjit propozohet ndryshimi i nenit 18, në kuadër të ndryshimit të organit të varësisë është hequr togfjalëshi “me miratimin e Ministrit të Drejtësisë”. Në Pikën 2, është bërë një shtesë, në lidhje me përcaktimin e “kontraktimit të shërbimeve të tjera ndihmëse në arbitrazh” të cilat do të përcaktohen me rregullore, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.”

*Në nenin 14 të Projektligjit është parashikuar shtimi i nenit 18/1 i cili përcakton rregulla të përgjithshme për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Në legjislacionin tonë, deri më tani, një rregullim i tillë nuk është formalizuar. Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ-së bëhet sipas një praktike të ndjekur në vite, por pa pasur parashikime ligjore. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, i masave individuale që duhet të merren nga shteti shqiptar është detyrim që buron nga nënshkrimi i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Nga praktika e ekzekutimit të këtyre vendimeve, në shumë raste tejkalohet afati i përcaktuar 3 muajor për ekzekutimin. Kjo vjen si rrjedhojë e mospasjes së një procedure dhe përgjegjësie të përcaktuar qartë në legjislacion për ekzekutimin e tyre. Në këtë nen parashikohet procedura e ndjekur nga Avokatura e Shtetit dhe detyrimet e saj si organ iniciues për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, detyrimi i organeve përgjegjëse për ekzekutimin e masave individuale të përcaktuara, detyrimi i Ministrisë së Financave për ekzekutimin financiar të vendimeve, pasi merr njoftimin nga Avokatura e Shtetit.

*Në frymën e ndryshimeve të nenit 14, në nenin 15 të Projektligjit është parashikuar shtimi i nenit 18/2 i cili përcakton rregulla për marrjen e masave të përgjithshme për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së. Sipas këtyre parashikimeve Avokatura e shtetit pasi identifikon gjetjet e rekomanduara nga GJEDNJ, ja komunikon ato organit përgjegjës të administratës publike si dhe kërkon angazhimin e tyre për zgjidhjen e problematikës së konstatuar. ●Organi përgjegjës brenda 2 muajve ka detyrimin të japë kontributin e tij për problematikën e konstatuar, duke ofruar zgjidhjet përkatëse.

* Në nenin 15 të projektligjit është propozuar ndryshimi i nenit 19 të Ligjit ekzistues. Titulli i nenit bëhet “Akses i avokatëve të shtetit në gjykatë”. Në pikën 1 është propozuar përjashtimi nga detyrimi për të paguar *tarifat e shërbimit për veprimet që kryhen nga administrata shtetërore, gjyqësore, prokuroria, si dhe nga përmbaruesit gjyqësor shtetërorë*. Në sqarim të këtij ndryshimi, ja vlen të theksojmë se, përjashtimi nga këto tarifa do të minimizonte shpenzimet e tepërta të Institucionit të Avokaturës së Shtetit gjatë ofrimit të shërbimeve të saj, në rastet e mbrojtjes së interesave publike gjatë procesit gjyqësor.

Në pikën 3 të këtij neni, për herë të parë përcaktohet e drejta e avokatëve të shtetit, për të kërkuar kostot e përfaqësimit, për dhënien e ndihmës juridike. Në rast se, pala kundërshtarë përballë institucionit publik të përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit e humb çështjen gjyqësore dhe i ngarkohen me vendim gjyqësor të formës së prerë shpenzimet gjyqësore, tarifa e shërbimit të përfaqësimit gjyqësor të institucionit publik derdhet në buxhetin e Avokaturës së Shtetit. Të ardhurat e përfituara nga ky proces do të derdhen në buxhetin e shtetit. Masat e shpërblimit të Avokaturës së Shtetit për shërbimin e përfaqësimit gjyqësor për efekt të pikës

1, të këtij neni janë të barabarta me tarifat e shpërblimit në fuqi të avokatëve në profesion të lirë.

Në pikën 4 të nenit parashikohet mundësia e avokatëve të shtetit të kenë akses të plotë në dosjet në gjykim por edhe të të dhënave dhe dosjeve që ndodhen në organe të tjera shtetërore, me qëllim mbrojtjen dhe përfaqësimin e zaurues të interesave të shtetit. Gjithashtu, ky akses parashikohet edhe për të garantuar verifikimin dhe inspektimin e punës së avokatëve të shtetit, me qëllim ngritjen profesionale të tyre.

Në praktikë, avokatët e shtetit hasin në vështirësi për nxjerrjen e dëshmive të trashëgimisë për personat të cilët vlerësohet të kenë cënuar interesat e shtetit shqiptar, për këtë arsye në pikën 5 është parashikuar se *“dëshmia e trashëgimisë e kërkuar nga Avokatura e Shtetit, lëshohet nga gjykata e shkallës së parë.”*

* Propozimet e bëra në nenin 16 të projektligjit, për ndryshimin e nenit 20 të ligjit, lidhur me kushtet për t'u emëruar Avokat Shteti, janë të ndërlidhura me ndryshimet e propozuara në nenet e tjera në projektligj, dhe në mënyrë të veçantë me objektin e këtij ligji i cili ka në sintezën e tij rregullimin e “Statusit të Avokatit të Shtetit”.

Duke qenë se, Avokatët e Shtetit në ushtrimin e funksioneve janë pjesë e mirëfilltë e sistemit gjyqësor, në këtë linjë është propozuar që Avokatët e Shtetit pas përfundimit me sukses të konkurimit të fitojnë titullin “Avokat Shteti”, duke referuar këtu për analogji titullin që fiton gjyqtari apo prokurori pas kalimit të procesit të formimit teorik. Pikërisht miratimi i një rregullimi të tillë në projektligj, si edhe kemi cituar më lart, do të rrisë cilësisht prurjet e Avokatëve të Shtetit pranë këtij institucioni gjë që do të ndikojë në rritjen cilësore të mbrojtjes së interesave financiare dhe pasurore të Shtetit Shqiptar.

Në tërësinë e tij Institucioni i Avokatit të Shtetit nuk është një institucion i cili mund të plotësohet thjesht nga radhët e juristëve që kanë një formim të përgjithshëm. Kërkon shumë më tepër përvojë dhe njohuri të fushës legjislative dhe procedurave gjyqësore. Vetëm duke parashikuar dispozita të tilla do të mund të rrisim cilësinë e profesionistëve, që do t'i bashkëngjiten këtij institucion, me qëllim mbrojtjen më të mirë të interesave pasurore dhe financiare të Shtetit Shqiptar, si brenda dhe jashtë vendit. Pika 2 e nenit, synon të shmangë krijimin e mungesave dhe mosfunksionimin normal të veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit, në ato raste kur mungojnë kandidatët e ardhur nga Shkolla e Lartë e Magjistraturës.

*Në nenin 17 të projektligjit është parashikuar shtimi i katër neneve, të cilat rregullojnë procedurën e thirrjes për aplikime për pozicionin e avokatëve të shtetit pranë Shkollës së Magjistraturës, aplikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve, provimin për pjesëmarrjen në këtë shkollë, vlerësimin si dhe stazhin profesional për avokatët e shtetit. Kjo shtesë ka ardhur si domosdoshmëri dhe kërkesë e nenit 244 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i cili tashmë ka përcaktuar se avokatët e shtetit do të formohen profesionalisht pranë Shkollës së Magjistraturës.

* Neni 18 parashikon ndryshimin e nenit 21 të ligjit, duke parashikuar se emërimi i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me propozim të Kryeministrit. Kjo do të bëhet në funksion të rolit dhe rëndësisë që do ti jepet këtij institucioni. Gjithashtu, në këtë nen është parashikuar *rregullimi i mënyrës së emërimit të Avokatëve të Shtetit*. Konkretisht, në projektligj është propozuar që Avokat Shteti të emërohen në detyrë kandidatë që kanë përfunduar *Shkollën e Magjistraturës*, duke marrë në konsideratë rezultatet e studimeve. Një propozim i tillë bëhet me synim përfshirjen në këto funksione të individëve të cilët vijnë nga një *“background”* formimi i specializuar, si është Shkolla e Lartë e Magjistraturës, e cila tashmë ka konsoliduar një praktikë të sukseshme në

drejtim të diplomimit të profesionistëve të sistemit gjyqësor si dhe për të konsoliduar statusin e avokatëve të shtetit. Në raste të tjera është parashikuar që kandidatët të emërohen në detyrë në bazë të një procedure konkurimi të hapur publike, por ky emërim, nuk mund të zgjasë më shumë se 3 vjet.

Në këtë nen, veç sa më sipër, saktësohet rregullimi i emërimit me qëllim *fitimin e titullit "Avokat Shteti"*, procedura e ndjekur në raste të veçanta, për plotësimin e vendeve kur ka mangësi si dhe, emërimi i drejtuesve të Strukturave, në të dyja nivelet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

*Në nenin 19 projektligjit, parashikohen ndryshimet e pikave 1 dhe 2 të nenit 22. Në pikën 1 është parashikuar zëvendësimi në detyrë i drejtuesve të zyrave në Avokaturën e Shtetit, nga avokatët e shtetit në nivel qëndror. Ky ndryshim ka ardhur si rrjedhojë e përjashtimit të rasteve kur ka vakanca të drejtuesve të zyrave, në nivel qëndror. Ndërsa, ndryshimi në pikën 2 të nenit, ka ardhur si rezultat e ndryshimit të varësisë së institucionit.

* Në nenin 20, parashikohet ndryshimi i nenit 23, në lidhje me papajtueshmërinë e funksioneve të avokatit të shtetit, duke përjashtuar nga ky parim, *"veprimtaritë akademike të mësimdhënies"*.

* Neni 21 i projektligjit, parashikon një ndryshim të pikës 2 të nenit 24 të ligjit aktual, duke përcaktuar se gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe avokatët e shtetit i përmbahen dispozitave të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

*Një ndryshim tjetër parashikohet në nenin 22 të projektligjit, i cili lidhet me lirimin dhe shkarkimin e avokatëve të shtetit. Pika 3 parashikon që lrimi/shkarkimi nga detyra i avokatëve të shtetit dhe i drejtuesit të strukturave të Avokaturës së Shtetit bëhet me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, ndërsa, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, do të lirohet/shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me propozim të Kryeministrit.

* Në nenin 23, të projektligjit është shtuar një kre më vete, Kreu VI/I, "Statusi dhe karriera e avokatit të shtetit", i cili qartëson kuptimin e Statusit që do të gëzojë Avokati i Shtetit. Paralelizimi i Statusit të Avokatit të Shtetit me Statusin e Prokurorit dhe përshtatja e tij sipas hierarkisë funksionale nuk është bërë pa qëllim. Kjo për vetë faktin që natyra e veprimtarisë të Avokatëve të Shtetit është e ngjashme me atë të Prokurorëve, referuar faktit që Prokurorët janë mbrojtësit e shtetit të "akuzës penale" ndërkohë që Avokatët e Shtetit janë mbrojtësit e shtetit për pjesën e "akuzës civile". Aktualisht statusi protokollar i Prokurorit të Përgjithshëm është i barabartë me atë të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Kjo dallohet lehtësisht nga VKM nr.229/2004 "Për miratimin e ceremonialit zyrtar në Republikën e Shqipërisë" ku Prokurori i Përgjithshëm dhe Avokati të Përgjithshëm të Shtetit i përkasin një rangui protokollar, menjëherë pas funksionarëve më të lartë të shtetit. I njëjti trajtim behët edhe në VKM nr.335/1997 për trajtimin e statusit diplomatik të autoriteteve të shtetit. Rrjedhimisht, nëpërmjet propozimeve të paraqitura synohet trajnimi i Avokatëve të Shtetit nga Shkolla e Magjistraturës çka do të rrisë cilësisht kapacitetet e tyre profesionale, sidomos për prurjet e reja në institucion.

* Gjithashtu, në varësi të kreut të mësipërm në nenin 24 të projektligjit janë parashikuar ndryshime të rëndësishme nenit 27 të Ligjit, duke përcaktuar, se rritja e nivelit të përgatitjes paraprake dhe arsimimit, duhet t'i kundërpërgjigjet një niveli page të barabartë me

kualifikimin, për të afruar pranë kësaj strukture kandidatë profesionistë. Në këtë këndvështrim, nëpërmjet ndryshimeve, është propozuar unifikimi në nivel pagash dhe shpërblimesh me nivelet e pagave me Institucionin e Prokurorisë. Pikërisht kjo përjasje është bërë për shkak se, *për nga natyra dhe rëndësia, roli i Avokaturës së Shtetit në fushën civilo-administrative është i ngjashëm me funksionin e Prokurorisë në fushën penale*, të dy institucionet mbrojnë interesin e shtetit: e para duke ndjekur penalisht autorët e krimeve dhe kundërvajtjeve; ndërsa e dyta duke i ofruar asistencë juridike shtetit në marrëdhëniet civilo-administrative me shtetasit, për të rritur cilësisht funksionimin e Institucionit të Avokaturës së Shtetit. Në këtë nen është parashikuar dhe rregullimi i pagës së punonjësve të administratës mbështetëse me Vendim të Këshillit të Ministrave.

* Në nenin 25 të projektligjit është parashikuar, krijimi i fondit dhe shpërblimit të avokatëve të shtetit, duke u bërë shtesa dhe ndryshime në nenin 28 të ligjit ekzistues. Me këtë rast, në buxhetin e Avokaturës së Shtetit, do të krijohet një fond i vecantë, i cili do të përdoret për shpërblim të posaçëm për avokatët e shtetit, në çështjet gjyqësore, të veçanta, të vështira dhe më interes të madh ekonomik dhe financiar. Ky buxhet do të jetë në masën 10% të Buxhetit të Avokaturës së Shtetit. Klasifikimi i këtyre çështjeve, kriteret, mënyra dhe procedurat e përdorimit të këtyre të ardhurave, përfshirë shpërblimin e avokatëve të shtetit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” Një parashikim i tillë, ka qenë i përcaktuar, në nenin 28 të ligjit aktual, por nuk është zbatuar asnjëherë. Me ndryshimin e propozuar, do të synohet që ky parashikim të jetë efektiv. Të dyja ndryshimet në këtë kre, do të ndikonin drejtpërdrejt në rritjen e performancës të Avokaturës së Shtetit, dhe ajo eka është më e rëndësishmja, rritjen e çështjeve të fituara të cilat direkt sjellin impakt në buxhetin e shtetit, në kuadër të uljes së vlerave të dëmshpërblimeve të kërkuara apo të drejtave të humbura.

*Në nenin 26 të projektligjit parashikohet ndryshimi i pikës 1 të nenit 32 të Ligjit. Ky ndryshim bëhet për t'i dhënë më shumë siguri statusit të avokatit të shtetit. Të drejtën për të filluar procedimin disiplinor ndaj avokatëve të shtetit e ka Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në përputhje me rregulloren e brendshme të Avokaturës së Shtetit.

*Në nenin 27 të projektligjit parashikohet të shtohet neni 32/1. Ky ndryshim vjen si domosdoshmëri e ndryshimit të nenit të mësipërm dhe të frymës së ndryshimeve të propozuara në tërësi. Një instrument i ri propozohet të ngrihet, i cili është Komisioni i Disiplinës. Rregullat e përgjithshme të punës së këtij Komisioni, mënyra e funksionimit të tij, përbërja etj përcaktohen në këtë nen. Ndërsa, rregulla më të hollësishme do të përcaktohen në rregulloren e brendshme të Avokaturës së Shtetit. Komisioni i Disiplinës është parashikuar si një organ i pavarur, i cili do të zhvillojë procesin disiplinor ndaj avokatëve të shtetit dhe do të dalë me një vendim lidhur me masat disiplinore ndaj avokatëve, duke bërë që të jepet një garanci më shumë për statusin e avokatëve të shtetit. Një parashikim i tillë u kërkuar dhe është iniciuar me ndihmën e ekspertëve të Euraliusit, për asyet e mësipërme.

* Në nenin 28, të Projektligjit, parashikohet ndryshimi i nenit 34 të Ligjit, nënshtrimi i avokatëve të shtetit ekzistues, fazave të detyrueshme trajtuese, pranë Shkollës së Lartë të Magjistraturës, brenda një afati 3 vjeçar nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore. Në përfundim të këtij trajnimit, avokatët e shtetit, do të nënshtrohen një provimi, për të marrë titullin “avokat shteti”. Fondet e nevojshme për realizimin e trajnimit fillestar dhe trajnimin vazhdues do të sigurohen nga buxheti i Avokaturës së Shtetit, ndërsa, rregullat për organizimin e trajnimit fillestar, vazhdues dhe provimin e avokatëve të shtetit, do të përcaktohen me Memorandum midis Shkollës së Magjistraturës dhe Avokaturës së Shtetit.

*Në nenin 29 të Projektligjit parashikohen organet që do të nxjerrin Rregulloret për funksionimin e Avokaturës së Shtetit si dhe afatet brenda të cilave duhet të nxirren këto rregullore.

DEPUTETI

Ilket Hyseri
14/10/2018